



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e parë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më 24.4.2024 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

#### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;
3. Propozim-vendimi për zyrtarizimin e emërimit të Parkut memorial në oborrin e bibliotekës kombëtare "Të zhdukurit me dhunë nga Serbia";
4. Anulimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010, të dt. 05.09.2023;
5. Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024;
6. Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunktional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës - Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
7. Propozim-vendimi për nismën e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal;

Faqe 1 nga 2

F.K

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://eëë.priština-komuna.org>

8. Propozim-vendimi për vazhdimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative "Don Bosko";
9. Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projekt-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;
10. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;
11. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera;
12. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-060/01-48066/24, më 12.4.2024

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina



F.K.

Faqe 2 nga 2